

2020

Monitorimi i
Strategjisë
Kombëtare për
Barazinë
Gjinore

POGRADEC



Monitorimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Pogradec

VITI 2020

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH), në kuadrin e projektit *"Sigurimi i ekspertizës teknike për qeverinë dhe OSHC-të për zhvillimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e masave për adresimin e dhunës ndaj grave në Strategjinë e re për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit"*, Projekti zbatohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave", financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë

Përmbajtja e këtij raporti është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim, dhe nuk reflekton opinionin e SIDA, UNDP, UNFPA dhe UN Women.

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	5
RRETH ORGANIZATAVE ZBATUESE	5
PËRSE MONITORIM I SKBGJ-SË NGA OSHC-TË?	6
METODOLOGJIA.....	6
MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020	8
GJETJET KRYESORE.....	8
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË POGRADEÇ	9
TË DHËNA STATISTIKORE NGA MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT (MKR) POGRADEÇ.....	9
TË DHËNA NGA DREJTORIA VENDORË E POLICIË PËR BASHKINË POGRADEÇ.....	10
TË DHËNA NGA GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR, BASHKIA POGRADEÇ	11
TË DHËNA NGA PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR, BASHKIA POGRADEÇ.....	12
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2020	13
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	13
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE	18
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN E TYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA.	21
KONKLUZIONE TË RËNDËSISHME.....	22
REKOMANDIME KRYESORE	23

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjvQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZhK “Sot për të Ardhmen”	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
REVALB	Sistemi elktornik (on-line) i rregjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Hyrje

Ky raport u hartua në kuadër të Projektit "Sigurimi i ekspertizës teknike për qeverinë dhe OSHC-të për zhvillimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e masave për adresimin e dhunës ndaj grave në Strategjinë e re për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit", në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave", të financuar nga Qeveria e Suedia i cili po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë shqiptare. Në Shqipëri projekti u zbatua nga Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", në bashkëpunim me disa organizata të tjera joqeveritare. Bashkitë e përfshira në monitorim ishin bashkitë e Lezhës, Kamzës, Fierit, Sarandës dhe Pogradecit.

Qëllimi i projektit është monitorimi i i detyrimeve ndërkombëtare dhe kombëtare të Shqipërisë për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Procesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2016-2020 për bashkitë e lartpërmenduar u zhvillua përgjatë periudhës nëntor 2020 - maj 2021. Aktivitetet në nivel qendror u monitoruan nga QAGjZh dhe në nivel lokal nga organizatat lokale, përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin të Qëllimit strategjik 3 të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016 – 2020.¹

Gjatë zbatimit të projektit u arrit që:

1. Të realizohej monitorimi i punës për ti dhënë fund dhunës kundër grave dhe vajzave nëpërmjet mekanizmeve të referimit si një mjet i cili identifikon arritjet dhe sfidat apo boshllëqet ekzistuese.
2. Organizatat partnere në projekt të rrisin kapacitetet për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planti të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020;
3. U përdorën rezultatet nga monitorimi i fazës së parë për të kontribuar në përpilimin dhe implementimin e Strategjisë së re të Barazisë Gjinore duke filluar nga vitit 2021.
4. U realizua procesi i promovimit dhe advokimit, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e nisi punën me organizimin e seancave informuese me përfaqësuesit e organizatave partnere në 5 bashkitë nën monitorim, bazuar në udhëzuesin për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të realizuar nga GADC në Nëntor 2019 dhe të rishikuar në fillim të vitit 2020. Përveç manualit u hartuan skedat monitoruese bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të cilat u përdorën gjatë procesit të monitorimit.

Rreth organizatave zbatuese

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore;

¹ <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Gjatë procesit të monitorimit të bashkive Fier, Lezhë, Pogradec, Sarandë dhe Kamëz QAGJZh bashkëpunoi me disa organizata të tjera të cilat veprojnë në territorin e bashkive nën monitorim si: Qendra Rinore Vlorë, Epoka e Re Fier, Tjetër Vision, Elbasan dhe Shoqata për Integrimin e Zonave Informale Kamëz.

Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marrëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktime të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtarë që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatojmë një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Një eksperte lokale u përzgjedh për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2020.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

- Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njëzuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.
- Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:
 - Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
 - Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
 - Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
 - Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuese të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikën për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t’i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të

mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MSHMS në nivel qendror në adresën www.revalb.org

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2020.

Gjetjet kryesore

- Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) të Bashkisë Pogradec janë identifikuar dhe mbështetur me shërbime 106 viktima të dhunës në familje.
- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020 në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Pogradec janë regjistruar në total 30 kërkesa për leshim të UMM, të cilat janë pranuar të gjitha nga Gjykata. Nuk ka pasur kërkesa për leshim të Urdhërit të Mbrojtjes (UM) si dhe nuk është shqyrtuar nga Gjykata Pogradec asnjë kërkesë për shkelje të Urdhërave të Mbrojtjes.
- Përgjatë vitit 2020 pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Pogradec janë evidentuar 58 raste të dhunës në familje, ku 45 prej viktimave ishin gra dhe vajza. Ndërkohë që numri i rasteve të veprës penale “dhunë në familje” neni 130/a për vitin 2020 ishte 18 dhe u arrestuan 15 autorë.
- Bashkia Pogradec gjatë vitit 2020 në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile që operojnë në territorin e saj ka organizuar 17 aktivitete me komunitetin për ndërgjegjësimin për të mos pranuar dhunën me bazë gjinore dhe atë në familje.
- Bashkia Pogradec ka aprovuar një fond social të dedikuar për familjet dhe gratë në shumën 500.000 Lek por jo specifikisht për dhunën në familje, si dhe paga e koordinorit në shumën 530,880 lekë të reja bruto/vit.
- Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 9 takime të ekipit ETN të parashikuara ose ad-hoc (5 nga këto online) për të diskutuar për rastet dhe mënyrën e mbështjtes së viktimave të dhunës në familje.
- Gjatë vitit 2020 nuk është realizuar asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues për të marrë vendime apo edhe për të rishikuar politikën e marrëveshjes.
- Gjatë vitit 2020 Specialisti për DHBGJ dhe DHF mori pjesë në 8 trajnime për ofrimin e këshillimit dhe trajtimin e burrave dhunues organizuar nga Organizata Italiane CIES.
- Sistemi REVALB është përdorur nga koordinatori i dhunës në mënyrë frekvente, janë hedhur të dhënat në mënyrë periodike. Koordinatori has vështirësi për të përdorur të

gjitha rubrikat pasi është i detyruar të punojë me dy sisteme atë të REVALB dhe sistemin e MSHMS. Ky fakt krijon vonesa në hedhjen e të dhënave por edhe shumë ngarkesë në punë.

- Gjatë periudhës së izolimi janë mbajtur në kontakt nëpërmjet telefonit të gjitha rastet e dhunës në familje për cdo problem që kanë pasur. Gjithashtu në periudhën e izolimit në bashkëpunim me Fondin e Kombeve të Bashkuara, viktimat e dhunës u ndihmuan me pako ushqimore dhe higjenike.
- Bashkia Pogradec gjatë periudhës së pandemisë ka realizuar fushatën online për të denoncuar dhunën me sloganin: “Qëndroni në shtëpi por mos qëndroni në dhunë”. Kjo fushatë është bërë dhe në bashkëpunim me shoqatën “Unë Gruaja”-USAID dhe mbështetur nga Bashkia Pogradec.
- Puna e Koordinatorit Vendor është mbështetur në protokollin dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për rastet e dhunës në familje.
- Bashkia e Pogradecit ka nënshkruar marrëveshje me disa organizata me qëllim dhënien e shërbimeve sociale në mënyrë më profesionale tek target grupet që kanë nevojë për mbështetje dhe dhënie shërbimi, por një kontribut të madh në parandalimin e dhunës në familje dhe mbështetjen e viktimave të dhunës jep Organizata Jo qeveritare “Unë gruaja” e cila gjatë vitit 2020 ka mbajtur një peshë të konsiderueshme në organizimin e aktiviteteve dhe trajtimin e rasteve.
- Në datë 23 Tetor 2020 në bashkinë e Pogradecit u hap qendra e re që ofron Shërbime të Ndihmës Juridike Parësore Falas në shërbim të grave dhe burrave më në nevojë që jetojnë në këtë rajon. Kjo qendër hapet në kuadër të Projektit “Shtrirja e Shërbimeve të Ndihmës Ligjore Falas për Gratë dhe Burrat në Shqipëri,” i cili zbatohet në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe mbështetet nga Agjencia Austriake e Zhvillimit.
- Në Maj të vitit 2020 u nënshkrua nga Kryetari i Bashkisë z. Ilir Xhakolli, Karta Europiane për Barazi Gjinore. Nënshkrimi i kësaj karte ishte një hap i rëndësishëm në angazhimin që Bashkia e Pogradec do të ndërmarë në fushën e Barazisë Gjinore në nivel lokal në vitet e ardhshme.
- Përgjatë vitit 2020 zyra rajonale e punësimit pranë kësaj bashkie realizoi dhe ndërmjetësoi punësimin e 4 grave dhe vajzave, viktimave të dhunës në familje. 3 në sektorin publik (në ndërmarrjen e gjelbërimit) dhe 1 në sektorin privat për përpunimin e ullinjve.
- Në Shtator të vitit 2020 Këshilli Bashkiak ka miratuar Protokollin e Menaxhimit të rasteve të viktimave të Dhunës në familje në nivel vendor.
- Plani Vendor i Veprimit si pjesë e Kartës Europiane për Barazi u miratua në Këshillin Bashkiak në Shtator të vitit 2020.
- Për vitin 2020 Bashkia Pogradec nuk ka trajtuar viktimat e dhunës në familje me bonuse sociale sa i përket qerasë së banesës.
- Bashkia Pogradec vazhdon të mos ketë një zyrë të këshillimit të burrave dhunues dhe shërbime alternative dedikuar këshillimit dhe orientimit të këtij djemve dhe burrave dhunues.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Pogradec

Të dhëna statistikore nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) Pogradec

Gjatë vitit 2020 janë realizuar 9 takime të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar për menaxhimin e rasteve konsiderohet si takim i mekanizmit kundër dhunës, ashtu siç vërehet edhe nga lista e pjesëmarrësve, kjo pasi mendohet se duke qënë aktorë të përbashkët takimet janë konsideruar si të MKR Pogradec.

Në takimet e këtij ekipi janë diskutuar 27 raste dhe trajtuar në mënyrë të suksesshme 24 raste viktime të dhunës në familje. Për vitin 2020 nuk janë referuar raste në Strehëzën Kombëtare për viktimat e dhunës në familje nga Bashkia Pogradec, pasi rastet kanë preferuar të marrin ndihmë dhe të integrohen në vendbanimet e tyre. Koordinatorin referon se për vitin 2020 rreth 39 raste të viktimave të dhunës në familje janë duke u mbështetur për ri-integrimin e tyre ku antarë të MKR kanë dhënë kontributin e tyre. Hasen shumë vështirësi dhe sfida në ri-integrimin e këtij target grupi. Zyra e Punës bashkëpunon për ofrimin e punësimit por mbetet problem strehimi i viktimave me femijët e tyre në raste kur braktisin banesën. Bashkia Pogradec nuk ka ofruar bonus qeraje për asnjë rast të dhunës në familje që ka qenë në nevojë strehimi.

Tabela 1. Raste të suksesshme të trajtuara nga Mekanizmi i Referimit, Bashkia Pogradec

Rasti	Trajtimi
S.XH dhe GXH. 52 dhe 29 vjece viktime e dhunës në familje nga djali i saj.	S.Xh dhe G.XH janë nënë e bije dhe të dyja janë të dhunuara nga djali i tyre G.XH 32 vjec. Djali është i varur nga lëndët narkotike dhe vuan nga cregullime mendore kronike si pasoje e përdorimit të lëndëve narkotike. Shpesh herë në familje krijohesh situata të dhunshme si pasoje e presionit të djalit për të blerë lëndë narkotike dhe mos përgjigjja në mënyrë pozitive ktheheshe në dhunë psikologjike dhe kërcënime për jetën. Situata u degradua deri në pikën ku familja vendosi ta denoncojë djalin e tyre në polici. Gjatë denoncimit u thirr dhe Koordinatorin Kundër Dhunës për të bërë një vlerim rrisht. Duke parë që situata ishte goxha e rënduar nga ana psikologjike u mor vendimi për tu strehuar në qëndrën e emergjencës deri sa të dalim me një vendim gjykatë. Në datën 25 Nëntor u mor Vertetimi për Urdhër Mbrojtje. Ky vendim nuk u mor parasysh nga djali dhe që ditën e parë e theu Urdhërin e Mbrojtjes duke i kërcënuar familjarët me thikë në dorë. Kjo sjellje ishte e papranueshme për sigurinë e jetës edhe pse familja ishte në dilemë për të ridenoncuar për shkelje të urdhërit të mbrotjes mbasi u njoftua koordinatorin kjo sjellje ishte e papranueshme dhe e rrezikshme dhe u denoncua përsëri në komisariat ku GXH u mor masa e arrestit për thyerje të Urdhërit të Mbrojtjes. Gjatë kësaj periudhe disa nga antarët e MKR ofruan mbështetjen si për familjen e dhunuar me trajtim psikologjik për të kaluar këtë shok ashtu dhe nga Spitali Bashkiak Pogradec, Doktorin Psikiatër i spitalit për të trajtuar djalin në mënyrë mjeksore si nga varësia ndaj lëndëve narkotike ashtu dhe nga cregullimet mendore. U përgatit një anameze e plotë e G.XH si dhe u dhanë rekomandime në gjykatë nga Doktorin Psikiatër për trajtim të detyrueshëm me shtrim. Aktualisht gjëndja psikologjike e familjes është qetësuar, nuk ndihen të frikësuar për jetën e tyre si dhe janë të qeta që djali i tyre po trajtohet në mënyrë të specializuar.

Burimi: Koordinatorja Vendore, Bashkia Pogradec

Të dhëna nga Drejtoria Vendore e Policisë Pogradec

Përgjatë vitit 2020 pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Pogradec janë evidentuar 58 raste të dhunës në familje, ku 45 prej viktimave ishin gra dhe vajza. Ndërkohë që numri i rasteve të veprës penale “Dhunë në familje” neni 130/a për vitin 2020 ishte 18 dhe u arrestuan 15 autorë. Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020, sipas ligjit 9669, datë 18.12.2006, janë plotësuar 33 Kërkesë Padi për Urdhëra Mbrojtje. Detaje më të hollësishme të ndara sipas përshkrimeve përkatëse pasqyrohen si vijon më poshtë:

Tabela2. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Pogradec

Përshkrimi	Komisariati–Bashkia Pogradec	Drejtoria e përgjithshme e policisë së shtetit
Evidentuar	58	59
Të dëmtuar gjithsej	61	62
Prej tyre gra/vajza	45	45
KP.U. Mbrojtje	33	34
Sh.U. Mbrojtjes	3	3
V. P. Neni 130/a	18	18
Vrasje raste/viktima	1/1	1/1
Arrest. për 130/a	15	15
Ndaluar për 130/a	1	1
Gjendje të Lirë për 130/a	2	2
Në kërkim për 130/a	-	0
Autorë të vetëvrarë	-	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Pogradec

Sic shihet nga tabela të dhënat e marra nga secili burim konvergojnë me njëra tjetrën cka tregon se Policia e Pogradecit raporton në kohë reale të dhënat statistikore tek Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit. Pas ndryshimeve të ndodhura në ligj janë referuar raste të dhunës në familje por nuk është aplikuar nxjerrja nga banesa për shkak se viktima dhe dhunuesi nuk jetonin në të njëjtën banesë.

Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Pogradec

Gjatë vitit 2020, kërkesat për lëshimin e Urdhërave të Mbrojtjes si dhe Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes, pranë Gjykatës Pogradec, të specifikuara për çdo tre-mujor, paraqiten si më poshtë:

- Për tremujorin e parë, Janar –Mars 2020, janë 5 kërkesa të reja për lëshim UMM.
- Për tremujorin e dytë, Prill-Qershor 2020, janë 3 kërkesa të reja për lëshim UMM.
- Për tremujorin e tretë, Korrik –Shtator 2020, janë 14 kërkesa të reja për lëshim UMM.
- Për tremujorin e katërt, Tetor- Dhjetor 2020, janë 8 kërkesa të reja për lëshim UMM

Në total janë paraqitur 30 kërkesa për lëshim të UMM, të cilat janë pranuar të gjitha nga Gjykata. Nuk ka pasur kërkesa për lëshim të Urdhërit të Mbrojtjes (UM) si dhe nuk është shqyrtuar nga Gjykata Pogradec asnjë kërkesë për shkelje të Urdhërave të Mbrojtjes.

Në tremujorin e katërt, ka përfunduar gjykimi i 10 çështjeve civile me objekt lëshimin e UMM, nga të cilat 3 janë çështje të mbartura nga tremujori i tretë. Aktualisht, në fund të muajit Dhjetor 2020 ishte në shqyrtim pranë Gjykatës Pogradec vetëm 1 çështje me objekt lëshimin e UMM.

Në total gjatë vitit 2020, janë paraqitur në Gjykatën e Rrethit Pogradec 14 çështje penale lidhur me nenin 130/a dhe ka përfunduar gjykimi i 12 çështjeve.

Të dhëna nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Pogradec

Pavarësisht komunikimeve zyrtare me email por edhe kërkesave të Koordinatorit vendor Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Pogradec nuk ka raportuar asnjë informacion në lidhje me nenin 130/a/1,2,3,4, procedime penale, persona nën hetim etj.

Nga të dhënat e marra nga zyra përmbarimore shtetërore Pogradec gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020, zyra ka protokolluar gjithsej 32 urdhra mbrojtje dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtje.

Vlen të përmendet që të dhënat statistikore vjetore nga zyra përmbarimore shtetërore Pogradec nuk raporohen në mënyrë periodike pranë MKR dhe koordinatorit vendor Pogradec.

Gjithashtu ne i kemi konfrontuar këto të dhëna të zyrës përmbarimore Pogradec me të dhënat vjetore të cilat janë marrë nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror e cili citon se zyrat vendore përmbarimore ushtrojnë veprimtarinë e ekzekutimit të titujve ekzekutive, brënda juridiksionit të çdo rrethi gjyqësor të shkallës së parë, dhe jo në gjitha rastet përkon me juridiksionin administrative të nivelit Bashki.

Të dhënat statistikore të marra nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror paraqiten si më poshtë:

Referuar të dhënave progresive për vitin 2020 rezulton gjatë periudhës janar – dhjetor, numri total i çështjeve me objekt Pensione Ushqimore, është 360, dhe po të gjitha janë në ekzekutim të vazhdueshëm.

Gjithashtu, sqarohet se jo për të gjitha çështjet që janë në ekzekutim të vazhdueshëm, garantohet shlyerja e detyrimit, pasi debitori rezulton në pamundësi për të shlyer detyrimin dhe nuk ka të ardhura, pasuri e luajtshme apo e paluajtshme për të mundësuar ekzekutimin e detyrueshem të detyrimit. Për Zyrën Përmbarimore, Pogradec, nga 360 çështje që ka në ekzekutim të vazhdueshëm, vetëm për 23 çështje garantohet ekzekutimi i rregullt i detyrimit, për 337 nuk shlyhet fare detyrimi nga debitorët për pamundësi paguese, mungesë pasurie. Ndërkohë që sipas të dhënave të kësaj zyrë lokale, vetëm 1 çështje për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje është ekzekutuar gjatë vitit 2020. Ndërkohë që në total gjatë vitit 2020 ishin 7 çështje për ekzekutim të Urdhrit të Mbrojtjes të cilat sipas monitorimit dhe të dhënave janë ekzekutuar të gjitha.

Deklarohet nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror për vështirësitë me të cilat janë përballur më shumë përmbaruesit, duke iu referuar angazhimeve të marra për ekzekutimin e këtyre titujve ekzekutivë kanë qënë kryesisht:

- Nuk janë të pakta rastet kur masat e mbrojtjes të përcaktuara në vendimin e gjykatës nuk janë të qarta apo rastet kur dhunuesi ose debitori detyrohet të dalë nga banesa dhe Gjykata ka përcaktuar si detyrim të Shërbimit Social pranë pushtetit vendor për të gjetur strehim për dhunuesin/debitorin.
- Masa të tilla mbrojtje paraqesin vështirësi për tu ekzekutuar për shkak se pushteti vendor nuk ka mundësi të garantoje strehim për dhunuesin/debitorin.

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2020

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Pogradec gjatë vitit 2020 ka koordinuar 9 aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit për të mos pranuar fenomenin e dhunës në familje dhe marrëdhëniet familjare.

Në bashkëpunim me OJF-të që kanë aktivitet në bashkinë Pogradec, kryesisht “Unë gruaja”; Gruaja Intelktuale dhe 5 Njësitë administrative të bashkisë Pogradec janë organizuar 17 aktivitete ndërgjegjësuere. Aktivitete janë zhvilluar në ambiente të hapura ose online, me fokus sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit që dhuna nuk duhet të tolerohet.

Bashkia Pogradec nuk ka një buxhet të dedikuar për aktivitete ndërgjegjësuere apo dhe çështje të tjera të lidhura me dhunën në familje. Vihet re se është fokusuar më shumë në rolin e saj koordinues sesa financues. Aktivitetet Kundër Dhunës ndaj Gruas u organizuan me aktorë si: Bashkia Pogradec, Zyra për Barazi Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje, Shoqata Unë Gruaja, Gruaja intelektuale dhe Këshilli Bashkiak, Zyra Arsimore dhe Psikologët e shkollave, gjithashtu dhe nga shkolla Amaro-Tan pjesë e GTN.

Ndryshe nga vitet e tjera për shkak të situatës së krijuar nga pandemia aktivitetet u zhvilluan duke u organizuar në grupe të vogla njerëzish (sipas rregullave të imponuara nga #Covid-19). Gjatë muajit Tetor është organizuar një takim me të rinjtë e dy gjimnazeve të qytetit ku është folur mbi rëndësinë e denoncimit të rasteve të dhunës në familje dhe barazisë gjinore. Mbas aktivitetit të rinjtë krijuan një murale në Qendrën Rinore me temë “Barazia Gjinore, si duhet ta shikojmë botën”.

Çelja e fushatës më datë 25 Nëntor me sloganin *Bëje botën portokalli! #Dëgjo. #Beso. #Mbështet,* u realizua në një mënyrë shumë të veçantë nga Shoqata “Unë, Gruaja” dhe Bashkia Pogradec e cila bëri portokalli Sheshin e Trëndafilave, ku individë të shumtë iu bashkuan këtij këndi duke ndarë mesazhe sensibilizuese. Aktivitetet Kundër Dhunës ndaj Gruas u organizuan nga shoqata “Unë, Gruaja” në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec dhe Zyrën për Barazi Gjinore.

Ndryshe nga vitet e tjera për shkak të situatës së krijuar nga pandemia aktivitetet u zhvilluan duke u organizuar në grupe të vogla njerëzish (sipas rregullave të imponuara nga Covid-19)

Për herë të parë në Pogradec Shoqata “Unë, Gruaja” organizoi një takim me djem e burra me temë: “Le të flasim”. Në këtë takim u diskutuan rreth marrëdhënies midis djalit dhe babait, komunikimi, ndjenjat dhe emocionet që përjetojnë. Aktivitete sensibilizuese u realizuan edhe nga aktivistet e shoqatës në njësitë administrative përkatës duke realizuar takime të vogla me gra dhe folur rreth dhunës dhe parandalimit të saj. Në 16 ditët e aktivizimit nuk munguan edhe shkrimet, video dhe shpërndarja e materialeve informuese dhe sensibilizuese të cilat janë pasqyruar edhe në mediat online të Shoqatës “Unë, Gruaja”.

Nga të dhënat e ofruara nga koordinatori vendor dhe monitorimi, për numrin e pjesëmarrësve në këto aktivitete ka qenë mbi 100 persona. Listë-prezencat e ofruara janë të pjeshme pasi një pjesë e konsiderueshme e tyre mbahet nga NGO-të organizuese të aktiviteteve. Në takime kanë marrë pjesë kryesisht të rinj, anëtarë të MKR Pogradec, përfaqësues nga njësitë administrative dhe gra nga zonat rurale. Pjesëmarrja ka qenë e kufizuar për shkak të kufizimit të lëvizjeve gjatë pandemisë dhe kur është realizuar janë zbatuar masat e protokollit të MSHMS për organizime me jo më

shumë se 10 veta. Përsa i përket pjesmarrjes së komuniteteve ndërfetare deklarohet nga koordinatori vendor se, kanë qenë pjesëmarrës edhe 2 përfaqësues të komuniteteve ndërfetare përkatësisht nga komuniteti mysliman dhe nje nga komuniteti protestant.

Gjatë këtij viti janë nënshkruar 3 marrëveshje midis bashkisë dhe OSHC-ve

- 1- Është nënshkruar karta Europiane për Barazinë Gjinore
- 2- Marrëveshja e bashkëpunimit midis Bashkisë Pogradec dhe shoqatës “Unë Gruaja”
- 3- Marrëveshja midis bashkisë dhe Grupit Rinor Pogradec

Sipas KV, përgjatë 2020 janë realizuar 7 trajnime të përbashkëta të organizuara me antarët e MKR për përmirësimin e efektivitetit të shërbimeve ndër-disiplinare. Këto trajnime janë organizuar nga shoqata “Unë Gruaja” në kuadër të zbatimit të projektit me titull “Mbështetje për bashkitë në analizimin dhe adaptimin e modeleve/skemave të reja për integrimin socio-ekonomik të të mbijetuarave të DhBGj & DhF në partneritet me Rrjetin Shqiptar për Fuqizimin e Gruas (AWEN) dhe mbështetur financiarisht nga UN Women. Në të gjitha trajnimet e organizuara koordinatori vendor ka marrë pjesë në mënyrë aktive.

Shoqata „Refleksione“ ka organizuar një trajnim mbi ndryshimet e fundit ligjore për ligjin e dhunës në familje me anëtarët e MKR. Ky trajnim u realizua gjatë fushatës 16 ditore në Dhjetor 2020. Gjithashtu, kjo shoqatë ka organizuar me të njëjtën temë, trajnimin e gazetarëve të qytetit të Pogradecit për të rritur sensibilitetin e tyre për rastet e dhunës në familje por edhe rëndësinë e pasqyrimin në media të politikave dhe çështjeve gjinore. Mbas këtij takimi KV sëbashku me Organizatorët morën pjesë në një emision televiziv të një televizioni lokal me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet për denoncimin e rasteve të dhunës në familje por dhe për të diskutuar problematikat që u ndeshën këtë vit.

Përgjatë këtij viti të jashtëzakonshëm Bashkia e Pogradecit është e angazhuar për të punuar kundër dhunës në familje pasi viktimat e dhunës në familje gjatë kohës së pandemisë janë kategoria më vulnerabël që janë prekur nga kjo situatë. Janë marrë nisma të ndryshme për këtë kategori sic është ndihma me pako ushqimore dhe higjienike si nga fondet e bashkisë ashtu dhe nga ndihmat e donatorëve siç janë UNFPA, UNDP, USAID, Unë Gruaja etj.

Edhe pse në kohë pandemie, Bashkia e Pogradecit në Shtator të vitit 2020 ka hartuar me ndihmën e ekspertëve nga USAID Planin Vendor të Veprimit të Barazisë Gjinore 2020-2023 gjithashtu me Vendim të Këshillit Bashkiak ka miratuar dhe Protokollin e Menaxhimeve të rastit për viktimat e dhunës në familje dhe viktimave me bazë gjinore. Ky protokoll do i vijë në ndihmë të gjithë anëtarëve të mekanizmit për përgjegjësitë që ata kanë në rast dhune por dhe hapat që duhen të ndiqen.

Gjatë periudhës së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 kujdesi i Mekanizmit të Referimit pranë bashkisë Pogradec ndaj viktimave të dhunës në familje ka qenë i shtuar. Për periudhën Janar-Mars 2020 (deri në fillimin e pandemisë) është ndjekur procedura normale e funksionimit të MKR. Janë organizuar takime të rregullta me aktorët e mekanizmit, takime individuale, si dhe janë organizuar 3 takime të ETN gjatë periudhës Janar-Prill për të diskutuar mbi rastet e referuara dhe mbështetjen e nevojave të tyre.

Për periudhën Mars-Prill 2020 shoqata “Unë, Gruaja”, ka ofruar këshillim psikologjik e juridik nëpërmjet telefonit dhe rrjeteve sociale, FB, Instagram, What’s up. Janë realizuar në total 138 seanca këshillimi dhe janë mbështetur 58 gra, prej këtyre 17 janë raste të reja.

Gjatë viti 2020 bashkia Pogradec nëpërmjet koordinimit të veprimeve me OSHCtë që veprojnë në territor dhe mbështetjen nga donatorë të ndryshëm ka realizuar një sërë aktivitete në funksion të kauzës kundër dhunës në marrëdhëniet familiare si dhe rritjes së kapaciteteve të stafëve të bashkive. Disa nga këto organizata ndërkombëtare janë: UN Women Albania e cila zbaton në qytetin e Pogradecit në partneritet me Rrjetin Shqiptar për Fuqizimin e Gruas (AËEN) projektin me titull “Mbështetje për bashkitë në analizimin dhe adaptimin e modeleve / skemave të reja për integrimin socio-ekonomik të të mbijetuarave të DhBGj & DhF”.

Agjencia Austriake e Zhvillimit (Österreichische Botschaft Tirana/Ambasada Austriake Tiranë) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë bënë të mundur hapjen e qendrës ligjore falas në Bashkinë e Pogradecit me datë 23 Tetor 2020. Kjo qendër e re ofron Shërbime të Ndhmës Juridike Parësore Falas në shërbim të grave dhe burrave më në nevojë që jetojnë në këtë rajon. Kjo është qendra e 6-të që hapet në kuadër të Projektit “Shtrirja e Shërbimeve të Ndhmës Ligjore Falas për Gratë dhe Burrat në Shqipëri”. Qendra do i ofrojë këto shërbime falas përmes punonjësve të sapoemëruar publikë, si dhe do të administrohet nga Drejtoria e Ndhmës Juridike falas në Ministrinë e Drejtësisë.

Gjithashtu, Bashkia Pogradec është mbështetur nga USAID, e cila në Shtator të vitit 2020 ka hartuar me ndihmën e ekspertëve të USAID Planin Vendor të Veprimit të Barazisë Gjinore 2020-2023 dhe me Vendim të Këshillit Bashkiak ka miratuar dhe Protokollin e Menaxhimeve të rastit për viktimat e dhunës në familje dhe viktimave me bazë gjinore. Ky protokoll u vjen në ndihmë të gjithë anëtarëve të mekanizmit për përgjegjësitë që ata kanë në rast dhune por dhe hapa që duhet të ndiqen.

Tabela3. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr.	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1	27 Tetor	Pogradec	“Zbatimi i Planeve të Integritimit Socio – Ekonomik për viktimat e dhunës në familje apo të formave të tjera të dhunës.” në kuadër të Projektit ‘Mbështetja e bashkive në analizimin dhe adaptimin e modeleve/skemave të reja për integrimin socio – ekonomik për viktimat e DhBGj –DhF.	Shoqata “Unë, Gruaja” në bashkëpunim me bashkinë Pogradec
2	25 Nëntor	Pogradec	Bëje botën portokalli! #Dëgjo. #Beso. #Mbështet. Shoqata “Unë, Gruaja” në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec dhe Zyrën për Barazi Gjinore, hapi Fushatën 16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës ndaj Gruas në	Shoqata “Unë, Gruaja” në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec dhe Zyrën për Barazi Gjinore, Ky aktivitet mbështetet nga AWEN_rrjeti_fuqizimit_të_gruas

			Pogradec.	
3	26 Nëntor		<p>Takim me djem e burra në kuadër të fushatës Global Guy Talk. Burratedjemetëflasin</p> <p>Në këtë takim u diskutua rreth marrëdhënies midis djalit dhe babait , komunikimit dhe ndjenjave e emocioneve që përjetojnë.</p>	Shoqata “Unë, Gruaja” në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec
4	27 Nëntor			
5	29 Nëntor	Nj.Adm.Udënisht	<p>Në kuadër të fushatës 16 ditë aktivizëm vajza dhe gra përkatësisht të moshave 25-45 vjeç të Nj.Adm.Udënisht, u bënë bashkë për të folur rreth dhunës.</p>	Shoqata Une gruaja dhe Njesia administrative udënisht. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit “Shërbime të koordinuara dhe ndërhyrje profesionale për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, mbështetur nga @AËEN-Albanian Women Empoëerment Netëork dhe financuar nga
6	30 Nëntor		<p>“Pamundësia për tu angazhur në punë dhe të qenit të pavarura shprehet një grua e bën edhe më të vështirë raportimin e saj në institucione.” Ato vlerësuan takimet e këtij lloji dhe informacionin e marrë</p>	Shoqata Une gruaja dhe Njesia administrative. Ky aktivitet u realizua ne kuader te projektit “Shërbime të koordinuara dhe ndërhyrje profesionale për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, mbështetur nga AËEN-Albanian Women Empoëerment Netëork me fonde të #SIDA
7	1 Dhjetor	NJ.A Tushemisht	<p>Tema e dhunës ndaj gruas dhe format e saj më të përhapura.</p>	Ky aktivitet realizohet nga shoqata UG dhe NJA në kuadër të projektit: “Shërbime të koordinuara dhe ndërhyrje profesionale për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, mbështetur nga AWEN_rrjeti_fuqizimit_te_gruas , me fonde të SIDA
8	2 Dhjetor	Nëna dhe mësuese të ciklit fillor Pogradec	<p>#Dëgjo. #Besoj. #Mëso</p> <p>Tematika e takimit ishte dhuna ndaj gruas si edhe ndikimi i saj tek fëmijët.</p>	Ky aktivitet realizohet nga shoqata UG në kuadër të projektit: “Shërbime të koordinuara dhe ndërhyrje profesionale për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”,

				mbështetur nga AWEN_rrjeti_fuqizimit_te_gruas , me fonde të SIDA
9	3 Dhjetor	Pogradec me nje grup te rinjsh	Si po e përballojnë situatën e pandemisë gratë dhe të rinjtë? - Dhuna në kushtet e pandemisë. - Diskutim mbi raste problematike të cilat lidhen me përdorimin e alkolit, kushtet e vështira ekonomike, jetesa me disa breza	Ky aktivitet realizohet nga shoqata UG ne bashkepunim me koordinatoren vendor në kuadër të projektit: “Shërbime të koordinuara dhe ndërhyrje profesionale për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, mbështetur nga AWEN_rrjeti_fuqizimit_te_gruas , me fonde të SIDA
10	4 Dhjetor	NJA Bucimas	#Dëgjo #Beso #Mbështet“përballja me kushtet e vështira të pandemisë dhe rastet e dhunës të identifikuara gjatë kësaj periudhe	Ky aktivitet realizohet nga shoqata UG ne bashkepunim me NJA në kuadër të projektit: “Shërbime të koordinuara dhe ndërhyrje profesionale për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, mbështetur nga AWEN_rrjeti_fuqizimit_te_gruas, me fonde të SIDA
11	5 Dhjetor	Shkolla “Kozma Basho”, Pogradec	Takim me nxënësit e shkollës me tematike Dhunën dhe pasojat që ajo sjell në jetën tonë	Ky aktivitet realizohet nga shoqata UG ZA Pogradec me mbështetje të projektit: “Shërbime të koordinuara dhe ndërhyrje profesionale për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, mbështetur nga AWEN-Albanian Women Empowerment Netëork #SIDA #Dëgjo #Beso #Mbështet
12	6 Dhjetor	Pogradec – grup Infermierësh dhe specialistë të shëndetësisë	Identifikimi i hershëm i rasteve të dhunës nga punonjësit e shëndetësisë	Ky aktivitet realizohet nga shoqata UG ne bashkepunim me DSHP me mbështetje të projektit: “Shërbime të koordinuara dhe ndërhyrje profesionale për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, mbështetur nga AWEN-Albanian Women Empowerment Netëork , #SIDA #Dëgjo #Beso #Mbështet

13	7 Dhjetor	Pogradec, takimi ETN on line	Ndryshimet e fundit ligjore në ligjin 9669 "Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare".	Shoqata "Unë gruaja" në bashëpunim me Specialistin për Mbrojtjen e Grave të Dhunuara dhe Barazisë Gjinore, Bashkia Pogradec
14	10 Dhjetor	Pogradec	Përmbyllje e Fushatës -16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës ndaj Gruas	Shoqata "Unë gruaja" në bashëpunim me Specialistin për Mbrojtjen e Grave të Dhunuara dhe Barazisë Gjinore, Bashkia Pogradec
15	17 Dhjetor			
16	18 Dhjetor			

Burimi: Monitorim dhe Informacion nga Shoqata "Unë, gruaja" dhe Koordinator Vendor

Nuk ka informacion në lidhje me organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere nga organizatat me baze fetare përveç faktit që dy përfaqësues të saj kanë qenë pjesmarres te aktiviteteve të organizuara bashkia në bashkëpunim me OSHC.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Në Bashkinë Pogradec që prej vitit 2008 vepron Mekanizmi i Koordinuar i Referimit i cili bazohet në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për Masa ndaj Dhunës në marrëdhëniet Familjare", neni 8, pika 8 si dhe te VKM 334, datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij", hartuar në mbështetje të bazës legjislative të sipërcituar. Në kuadër të MKR një marrëveshje është firmosur midis anëtarëve të këtij mekanizmi. Qëllimi i marrëveshjes së firmosur midis antarësise së MKR është në përputhje me qëllimin e bazës ligjore mbi të cilën hartohet dhe konsiston në marrjen e masave të nevojshme përmes një koordinimi ndër-institucional. Gjatë vitit 2020 nuk është realizuar asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues për të marrë vendime apo edhe për të rishikuar politikat e marrëveshjes.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020 nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) të Bashkisë Pogradec janë identifikuar dhe mbështetur me shërbime 106 viktime të dhunës në familje Në Maj të vitit 2020 u nënshkrua nga Kryetari i Bashkisë z. Ilir Xhakolli, karta Europiane për Barazi Gjinore. Nënshkrimi i kësaj karte ishte një hap i rëndësishëm në angazhimin që Bashkia e Pogradec do të ndërmarë në fushën e Barazisë Gjinore në nivel lokal në vitet e ardhshme.

Në Shtator të vitit 2020 Këshilli Bashkiak ka miratuar Protokollin e Menaxhimit të rasteve të viktimeve të Dhunës në familje në nivel vendor. Ky protokoll është shumë i rëndësishëm pasi krijon një standart të ri në menaxhimin e rasteve tek të gjithë antaret e MKR. Gjithashtu metodologjia që përdoret tek ky protokoll shpreh shumë qartë se cilat janë rolet dhe detyrat e cdo antari të MKR.

Plani Vendor i Veprimit si pjesë e Kartës Europiane për Barazi, u miratua në Këshillin Bashkiak në Shtator të vitit 2020.

Gjate vitit 2020 janë realizuar 9 takime të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar, për menaxhimin e rasteve të cilat konsiderohen si takime i mekanizmit kundër dhunës, ashtu siç vërehet edhe nga lista e pjesëmarrësve, kjo pasi mendohet se duke qënë aktorë të përbashkët takimet janë konsideruar si të MKR Pogradec.

Në takimet e GTN-së janë diskutuar 27 raste dhe trajtuar në mënyrë te suksesshme 24 raste. Për vitin 2020 është referuar për trajtim 0 raste në Strehëzën Kombëtare për viktimat e dhunës në familje referuar nga Bashkia Pogradec, pasi rastet kanë preferuar të marrin ndihmë dhe të integrohen në vendbanimet e tyre.

Nga komunikimi me Koordinatorin por edhe hulumtimin e të dhënave vihet re se nuk ka një një protokoll të nënshkruar midis Policisë dhe bashkisë Pogradec përvec marrëveshjes së MKR. Pavarisht bashkëpunimit të kënaqshëm me Policinë vihet re se gjatë V. 2020 përfaësuesit e policisë nuk kanë qënë present në takime dhe nuk kanë shkëmbyer informacion statistikor mbi rastet e identifikuar prej tyre. Në rastet e referuara nga Policia të gjitha kërkesat për UM/UMM janë plotësuar nga Policia.

Gjatë vitit 2020 nuk është realizuar asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues për të marrë vendime apo edhe për të rishikuar politikat e marrëveshjes. Gjatë vitit 2020 koordinatori vendor I cili luan edhe rolin e Specialistit të DHBGJ dhe DHF ka marrë pjesë në 8 trainime për ofrimin e këshillimit dhe trajtimin e burrave dhunues organizuar nga Organizata Italiane CIES.

Sistemi REVALB është përdorur nga koordinatori i dhunës në mënyrë frekvente, janë hedhur të dhënat në mënyrë periodike. Koordinatorin has vështirësi për të përdorur të gjitha rubrikat pasi është i detyruar të punojë me dy sisteme atë të REVALB dhe sistemin e MSHMS. Ky fakt krijon vonesa në hedhjen e të dhënave por edhe shumë ngarkesë në punë. Drejtoria e shërbimit të provës nuk është pjesë e nënshkrimit të MKR dhe nuk ka një komunikim midis Shërbimit të provës dhe koordinatorit vendor përsa i përket ndarjes së informacionit.

Bashkia Pogradec nuk ka një buxhet të dedikuar për aktivitete ndërgjegjësuese apo dhe çështje të tjera të lidhura me dhunën në familje. Vihet re se është fokusuar më shumë në rolin e saj koordinues sesa financues. Bashkia Pogradec ka aprovuar një fond social të dedikuar për familjet dhe grate në nevojë në shumën 500.000 ALL por jo specifikisht për dhunën në familje, si dhe paga e koordinatorit në shumën 530,880 leke të reja bruto/vit. Koordinatorin thekson se nuk janë hartuar raporte të përmuajshme gjatë takimeve të MKR/ ETN por vë theksin se, në mbledhjet e grupit teknik përvec diskutimeve të rasteve diskutohet dhe periudha ecurise nga një takim tek tjetri duke përditësuar të rejtat e fundit.

Tabela 4. Numri i mbledhjeve të GTN-së në vitin 2020 në Bashkinë Pogradec

Data	Mbledhjet e GTN-së
	Përshkrimi i mbledhjes.
Dt 14.01.2020	ETN Pogradec (12 pjesëmarrës) Diskutim për 3 raste të dhunës në familje. Kerkuar nga Zyra Kunder Dhunës dhe NJMF.
DT 18.02.2020	ETN Pogradec (24 pjesëmarrës) Diskutim për 2 raste të dhunës në familje. kerkuar nga Zyra Kunder Dhunës në Familje.
Dt 09.03.2020	ETN Pogradec (22 pjesëmarrës) Prezantimi i Kartës Europiane për Barazi Gjinore, çfare përmban ajo dhe sesi duhet integruar ajo në bashki në planin e kujdesit social.

DT 24.04.2020	ETN Ora 11.00 Zoom Platform 5 pjesëmarrës (iniciimi i takimit per 2 raste emergjente nga UG)
Dt 22.06.2020	ETN dhe Gra nga Këshilli Bashkiak. Diskutim për hartimin e Planin Vendor të Barazisë Gjinore, aktivitete që duhen të përfshihen në këtë plan dhe koha e përcaktuar për të zhvilluar aktivitetet.
15.07.2020	Komisioni i Barazisë Gjinore në Këshillin Bashkiak. Takim për diskutimin për hartimin e Planit të Barazisë Gjinore dhe roli i Komisionit të Barazisë Gjinore në Këshillin Bashkiak.
10.09.2020	ETN (11 pjesëmarrës) Diskutim për 5 raste të dhunës në familje. Kërkuar nga Zyra Kunder Dhunes ne Familje dhe NJMF.
DT 27.10.2020	Tryeze konsultimi " une Gruaja dhe perfaqesues te MKR"- 27 Pjesëmarrës, projekti i mbeshetur nga AWEN/UN
07.12.2020	Në zbatim të Ligjit 9669 “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare Bashkia Pogradec realizoi online në Platformën zoom takimin e ETN për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Diskutim mbi ndryshimet e fundit ligjore në ligjin 9669 “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”. Juristja e Shoqatës Unë Gruaja. - Prezantim Aktivitetet në Kuadër të 16 Ditëve Aktivizëm kundër Dhunës ndaj Gruas. - Të flasim mbi problematikat dhe sfidat kryesore të rasteve të dhunës në familje gjatë vitit 2020 në situatën e Pandemisë COVID-19

Burimi: Monitorim i drejtpërdrejtë dhe Bashkia Pogradec

Tabela 5. Përbërja e Komitetit Drejtues, Bashkia Viti 2020

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2020
Bashkia	Kryetar Ilir Xhakolli
Drejtoria e Policisë	Komisar Artur Eabaj
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Kryetare Emona Muçi
Prokuroria e Rrethit	Prokurore Dorina Bejko
Drejtoria Arsimore Rajonale	Raqi Mangeri
Drejtoria e Shëndetit Publik	Elona Katiraj
Drejtoria e Shërbimit Social	Drejtoresha Rajonale Marjana Jorgji
Zyra e Përmbarimit	Athinela
Prefektura	Dhori Spirollari
Zyra e Punësimit	Drini Zeqollari
OSHC	Afroviti Gusho
Dhoma e Avokatisë	
Shërbimi Shëndetësor	Erjon Thengjilli

Tabela 6. Përbërja e GTN-së, Bashkia Pogradec, Viti 2020

Institucioni	Emër mbiemëri përfaqësuesit
Bashkia	Arbi Basho
Drejtoria e Policisë	Bledian Liçkollari
Gjykata e RrethitGjyqësor	Guri Sofi
Prokuroria e Rrethit	Dorina Bejko
DrejtoriaArsimoreRajonale	Moza Vesho
Drejtoria e ShëndetitPublik	Ermald Meko
Zyra e Përmbaramit	Klevis Cake
Prefektura	Mimoza Gusho
Kryetarët e Njësive Administrative	Nj.A Buçimas: Alfon Olldashi; Nj.A Çerrave Olger Ibi, Nj.Dardhas Erton Muçka; Nj.Proptisht Ramis Pura; Nj. Trebinje Ermal Tola; Nj. Udenisht Klodian Selko; Nj. Velçan Mentor Rapçe
Zyra e Punësimit	Luiza Krete
Organizata Jo qeveritare	Une Gruaja: Eleni Jajçari; Marin Piqoni Shkolla Amaro Tan, Gruaja Intelektuale Shpresa Blaceri
Strehëzat për viktimat e dhunës	
Komunitete fetare	
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	

Burimi: Bashkia Pogradec

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Ndryshimet e fundit të Ligjit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, të bëra me Ligjin 125/2020, kanë parashikuar: II-Neni 13/1 ,pika 2 "Në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, sipas pikës 1 të këtij neni,derisa gjykata të nxjerrë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes ,urdhërohet largimi i menjëhershëm i dhunuesit nga banesa, kur viktima dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë, përveç rastit kur dhunuesi është i mitur, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara, si dhe/ose përcaktohen një ose disa nga masat e mëposhtme....." Aktualisht me fillimin e zbatimit të ndryshimeve në ligj në bashkinë Pogradec nuk kemi ende të raportuar një masë të tillë. Në asnjë prej masave të dhëna nga gjykata pavarësisht dispozitave që parashikon ligji i rishikuar Nr 47-2018, dt 23.07.2018 nuk ka parashikuar programe rehabilitimi pranë subjekteve private apo publike për dhunuesit.

Në faqen e internetit të gjykatës nuk publikohen online të dhënat e UMM/UM, ato dalin veç në shortin ditor, gjithashtu nuk publikohen online vendimet UMM. Të dhënat janë siguruar pas dërgimit të një emaili zyrtar gjykatës së rrethit Pogradec. Në bashkinë e Pogradecit akoma nuk ka një projekt (qoftë dhe nga OJF të ndryshme që kanë aktivitet në qytet) për të punuar më kategorinë e burrave dhunues edhe pse Koordinatori vendor është dhe vazhdon trajnimin e ciklit të dytë për burrat dhunues. Planifikohet nga Shoqata "Une Gruaja që gjate V. 2021 të hapet një shërbim I tillë.

Per vitin 2020 prane DTSHP Pogradec kanë mbërritur 6 urdhra ekzekutimi për Dhunën në familje të parashikuara nga neni 130/a/1 dhe 130/a/4 te Kodit Penal. Në total jane trajtuar 15 raste të dënimeve alternative për veprën penale të dhunës në familje duke shtuar këtu dhe 9 raste të mbartura nga viti 2019. Aktualisht mbikqyren 7 raste të te mbikqyruve që janë dënuar për veprën penale të "Dhunës në familje"ⁱⁱ.

Zyra përmbartimore shtetërore Pogradec gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2020 ka protokolluar gjithsej 32 urdhra mbrojtje dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeⁱⁱ.

Edhe gjatë këtij viti nga monitorimi i statistikave të referuara nga koordinatori vendor sektori i shëndetësisë nuk ka patur asnjë rast referimi të dhunës në familje dhe kërkesë për UM.

Konkluzione të rëndësishme

Në Bashkinë Pogradec që prej vitit 2008 vepron Mekanizmi i Koordinuar i Referimit i cili bazohet në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", neni 8, pika 8 si dhe të VKM 334, datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij", hartuar në mbështetje të bazës legislative të sipërcituar.

- Gjatë vitit 2020 nuk është realizuar asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues për të marrë vendime apo edhe për të rishikuar politikat e marrëveshjes.
- Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020 nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) të Bashkisë Pogradec janë identifikuar dhe mbështetur me shërbime 106 viktima të dhunës në familje.
- Puna e Koordinatorit Vendor dhe ajo e bashkisë Pogradec është mbështetur në protokollet dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për rastet e dhunës në familje, protokoll i firmosur dhe zbatuar nga bashkia që në Prill të 2020. Gjatë vitit 2020 janë realizuar 9 takime të Ekipit teknik multidisiplinar, për menaxhimin e 27 rasteve dhe trajtuar në mënyrë të suksesshme 24 raste të DHF. Këto takime konsiderohen si takime të mekanizmit kundër dhunës, ashtu siç vërehet edhe nga lista e pjesëmarrësve, kjo pasi mendohet se duke qënë aktorë të përbashkët takimet janë konsideruar si të MKR Pogradec.
- Nuk ka evidence të raporteve të përmuajshme të këtyre takimeve apo dhe atyre të MKRse të shkëmbyera midis Koordinatorit dhe antarëve të ETN/MKR pasi një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve organizohen nga NGOte dhe janë ato që përgatisin liste presencat dhe raportet.
- Në Maj të vitit 2020 u nënshkrua nga Kryetari i Bashkisë z. Ilir Xhakolli, karta Europiane për Barazi Gjinore. Nënshkrimi i kësaj karte ishte një hap i rëndësishëm në angazhimin që Bashkia e Pogradec do të ndërmarë në fushën e Barazisë Gjinore në nivel lokal në vitet e ardhshme.

- Në Shtator të vitit 2020 Këshilli Bashkiak ka miratuar Protokollin e Menaxhimit të rasteve të viktimave të Dhunës në familje në nivel vendor. Ky protokoll është shumë i rëndësishëm pasi krijon një standart të ri në menaxhimin e rasteve tek të gjithë antaret e MKR. Gjithashtu metodologjia që përdoret tek ky protokoll shpreh shumë qartë se cilat janë rolet dhe detyrat e çdo antari të MKR.
- Plani Vendor i Veprimit si pjesë e Kartës Europiane për Barazi u miratua në Këshillin Bashkiak në Shtator të vitit 2020.
- Institucionet ligjzbatuese të mësipërme si antare të MKR përgjatë këtij viti kanë munguar në takime të ETN dhe nuk kanë shkëmbyer informacion zyrtar me koordinаторin për rastet e raportuara prej tyre. Vihet re një mungesë komunikimi zyrtar mes tyre e cila reflektohet në mosperpuethshmeri të statistikave.
- Bashkia Pogradec ka aprovuar një fond social të dedikuar për familjet dhe grate në nevojë në shumën 500.000 ALL por jo specifikisht për dhunën në familje, si dhe paga e koordinatorit në shumën 530,880 leke të reja bruto/vit.
- Bashkia Pogradec nuk ka një buxhet të dedikuar për aktivitete ndërgjegjësuese apo dhe çështje të tjera të lidhura me dhunën në familje. Bashkia luan rolin e saj koordinues sesa financues të aktiviteteve.
- Në periudhën Janar-Dhjetor 2020 3 viktimave dhune në familje janë strehuar në strehëzën e bashkisë për një periudhë 4 ditore dhe asnjë rast në qendrën kombëtare.
- Gjatë vitit 2020 Specialisti për DHBGJ dhe DHF mori pjesë në 8 trainime për ofrimin e këshillimit dhe trajtimin e burrave dhunues organizuar nga Organizata Italiane CIES.
- Bashkia Pogradec gjatë periudhës së pandemisë ka realizuar fushatën online për të denoncuar dhunën me sloganin: “Qëndroni në shtëpi por mos qëndroni në dhunë”. Kjo fushatë është bërë dhe në bashkëpunim me shoqatën Unë Gruaja-USAID dhe mbështetur nga Bashkia Pogradec.
- Për vitin 2020 Bashkia Pogradec nuk ka trajtuar asnjë viktimë të dhunës në familje apo familje të tjera në nevojë me bonuse sociale sa i përket qerasë së banesës.
- Bashkia Pogradec vazhdon të mos ketë një zyrë të këshillimit të burrave dhunues dhe shërbime alternative të dedikuara këshillimit dhe orientimit të këtij djemve dhe burrave dhunues.

Rekomandime kryesore

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Pogradecit për vitin 2020, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Pogradec dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Rekomandohet një rishikim i marrëveshjes së MKR dhe përditësimi i saj me antarësinë e re duke siguruar prezencën dhe bashkëpunimin e institucioneve si: Zyra e Përmbartimit Shtetëror Pogradec; Zyra e Shërbimit të provës pasi këto institucione nuk marrin pjesë në takime.
- Rekomandohet që bashkia duhet të ushtojë të gjithë detyrimet/sanksionet që përcaktohen në marrëveshjen e MKR për të gjitha ato institucione, pjesë e MKR të cilat nuk marrin pjesë në takime, nuk ofrojnë informacionin e kërkuar nga ana e koordinatorit ose nuk bashkëpunojnë për mbështetjen e viktimave.

- Koordinator i MKR-së i pavarësisht ngarkesës duhet të hartojë ose kërkojë nga NGOtë organizatore anëtare të MKR, shkëmbimin e informacionit, listë-prezencat dhe raportet e takimeve të MKR/GTNsë.
- Konsideruar situatën e prezantuar nga Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror rekomandohet që për të patur efikasitet në ekzekutimin e këtyre çështjeve është i domosdoshëm organizimi i trajnimeve të përbashkëta me përmbarrues gjyqësor, gjyqtarë, prokurorë, forca të rendit, urdhërin e psikologut, urdhërin e punonjësit social për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje.
- Bashkia duhet të ndajë fondin e dedikuar për DHF dhe marrëdhëniet familjare në zërin e Fondit Social të aprovuar gjatë vitit 2020.
- Pavarësisht nënshkrimit të protokollit për manaxhimin e rasteve në Shtator 2020 bashkia Pogradec duhet të hartojë dhe një plan emergjencë për t'ju përgjigjur rasteve të dhunës gjatë periudhave të tilla si kjo që po kalojmë. Në këtë kuadër rekomandohet instalimi dhe funksionimi i një linje telefonike në Bashki në përgjigje të rasteve emergjente. Ky funksion nuk mund ti lihet vetëm NGOve.
- Bashkia Pogradec duhet të llojë fuqishëm pranë qeverisë shqiptare për sigurimin e granteve për mbështetjen me bonus qeraje të grupimeve në nevojë dhe vecanti rasteve të dhunës në familje.
- Bashkia duhet të prezantojë pranë MSHMS vështirësinë që haset nga koordinatori për të përdorur të gjitha rubrikat pasi është i detyruar të punojë me dy sisteme atë të REVALB dhe atë të MSHMsë. Ky fakt ka krijuar vonesa në hedhjen e të dhënave si dhe ngarkesë në punë.
- Duke konsideruar faktin se koordinatori vendor është i trajnuar dhe vazhdon rritjen e kapacitetit të tij në drejtim të ofrimit të këshillimit të burrave dhunues, bashkia duhet të fillojë të konsiderojë buxhetimin e programeve për ofrimin e shërbimit të specializuar dhe seancave psiko-sociale për dhunuesit për rehabilitimin e tyre.

ⁱ Informacion i siguruar nga DTSH Pogradec

ⁱⁱ Informacion i siguruar nga Zyra Përmbarrimore Pogradec